
TRIBUNA SINDIKALE

Mars 2012

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë







Editorial

7 MARSI – DITA E MESUESIT

Eshte bere tradite qe cdo vit perkujtohet e festohet nga mesuesit, pedagoget, prinderit dhe nxenesit, nga i gjithe vendi, 7 Marsi – Dita e Mesuesit.

Kete vit Dita e Mesuesit mori nje kuptim e vleresim te vecante, sepse ajo u organizua ne shkalle kombetare dhe vendore ne kuadrin e veprimtarive per 100 Vjetorin e Shpalljes se Pavaresise.

E vecanta e festimeve te ketij viti ishte se veprimtarite kombetare kushtuar 7- Marsit u zhvilluan ne qytetin e Korces, atje ku 125 vjet me pare u cel Mesonjetorja e pare shqipe.

Veprimtarite kushtuar kesaj feste filluan me nje vizite te Kryeministrit, z. Sali Berisha, ne Shkollen Profesionale Ekonomike te ketij qyteti. Mbasi vizitoi ambjentet e shkolles, z. Berisha foli para mesuesve e nxenesve te kesaj shkolle dhe te ftuarve te tjere per rendesine qe ka zhvillimi dhe fuqizimi i arsimit profesional ne vend, per pergatitjen e specialisteve te afte ne dhjetra profesione per te cilat ka nevoje Shqiperia ne fusha te tilla si hoteleri- turizmi, sektore te tjere te sherbimeve mekanike, elektrike, ndertim, etj.

Mbreselense ishte vizita ne godinen muze ku 125 vjet me pare u hap shkolla e pare shqipe. Qe ne oborr, ku spikat monumenti ABC, por edhe ne klasat muze, sikur degjoheshin ne sfond te shoqeruar nga nje melodi e larget fjalet e Naim Frasherit te madh :

Lumja ti, moj Korc' o lule,
Q'i le pas shoqet e tua,
Si trimi ne balle u sule,
Ta pacim per jete hua!

Me pas te ftuarit dhe personalitetet shteterore moren pjese ne Konferencen Kombetare " 125 vjet Shkolle Shqipe", qe u zhvillua ne nje nga sallat e Universitetit "Fan Noli".

Ne kete Konference, ne prani te disa brezave te mesuesve e pedagogeve te shquar, te atyre qe kane dale ne pension dhe qe kane dhene nje kontribut te cmuar per zhvillimin dhe progresin e arsimit, te mesuesve e pedagogeve me pervoje dhe atyre me te rinj, te personaliteteve shteterore, perfshire Ministrin e Arsimit dhe Shkences, Ministrin e Financave, deputete, etj., Kryeministri z. Sali Berisha foli per arritjet ne fushen e arsimit ne vendin tone dhe kujdesin e vazhdueshem qe qeveria i ka kushtuar dhe do t'i kushtoje zhvillimit te ketij sektori, te cilin e ka shpallur dhe do te vazhdoje ta trajtoje si prioritar, sepse arsimi cilesor ne te gjithe hallkat e perberjes se tij qendron ne bazen e perspektives dhe progresit te vendit.

Ne keto ceremoni mori pjese edhe Zv/Kryeministri i Republikes se Maqedonise, z. Musa Xhaferi. Moren pjese, gjithashtu, edhe Kryetari i FSASH, z. Xhafer Dobrushi dhe Kryetari i SPASH, z. Bajram Kruja.

PERMBAJTJA

- 7 Marsi – Dita e Mesuesit 2
- Nenshkruhet Marrveshja e Bashkepunimit me sindikaten e Kosoves, SBASHK 3
- Projekt-Ligji per sistemin arsimor parauniversitar, shprehje e vleresimit per figuren, misionin dhe profesionin e mesuesit 5
- Funksionimi i dialogut social ne sektorin e arsimit, (disa konkluzione nga analiza e bere ne Keshillin Kombetar te Punes) 7
- Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH 9
- Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH 11
- Disa nga arritjet e SPASH gjate ketij manadati 12
- Takim me Drejtore te DAR/ZA-ve 14
- Botohet Manuali mbi angazhimin e FSASH e SPASH per eliminimin e punes se femijeve 15

Kopertina e pare:
Nga festimet me rastin e 7 Marsit

Kopertina e fundit:
Shtëpia muze e Mësonjëtores Shqipe të Korçes

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 43
Mars 2012

Botim i FSASH dhe SPASH

ADRESA:
Rruga "Dora D'Istria",
Pallati Perballe Fakultetit Juridik,
Tirane

Tel & Fax + 355 4 2 25 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795,
+ 355 68 21 52 891

E-mail: fsash@icc-al.org
Internet: www.fsash-spash.com

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis sindikatave shqiptare të arsimit, FSASH e SPASH, dhe sindikatës së arsimit të Kosovës, SBASHK

Pas një periudhe të gjatë bashkëpunimi, mbi bazën e një Marrveshjeje të nënshkruar vite më parë, dhe pas organizimit të disa aktiviteteve të përbashketa dhe konsultimeve të vazhdueshme, një



Marrëveshje e rëndësishme bashkëpunimi midis sindikatave shqiptare të arsimit, FSASH e SPASH, dhe sindikatës së arsimit të Kosovës, SBASHK, u nënëshkrua në Prishtinë, në datën 29 shkurt 2012.

Ne emër te sindikatave respektive, Marrëveshja u nënshkrua nga kryetarët e tyre, Xhafer Dobrushi, Bajram Kruja dhe Ali Shabanaj, në prezencë edhe të Presidentit te sindikatës së arsimit të Holandës, Walter Dresscher, Sekretares Ndërkombëtare të kësaj sindikate, Trudy Kerperien, dhe përfaqësuesit të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, Nicolas Richards, të cilët ndodheshin në Prishtinë për një vizitë pranë sindikatës së Arsimit të Kosovës.

Gjatë qendrimit në Prishtinë, delegacionet e FSASH e SPASH zhvilluan bisedime me përfaqësuesit e sindikatës së arsimit të Holandës, AOb dhe të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, duke u përqendruar tek forcimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit, sidomos në drejtim te konsolidimit të strukturave sindikale në të gjitha nivelet, rritjes së ndikimit të sindikatave në procesin e reformave, zhvillimit progresiv të sistemit arsimor dhe mobilizimit të mësuesve për mbajtjen e nxënësve në shkollë dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

Së bashku me përfaqësuesit e AOb dhe të EI, ata zhvilluan, gjithashtu, një Takim me Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Ramë Buja. Ne fillim të Takimit, kryetari i SBASHK-ut, Ali Shabanaj, informoi bashkëbiseduesit mbi vizitën e këtyre delegacioneve në Kosvë, mbi zbatimin e Projektit për Qendrën Multietnike dhe mbi nënshkrimin e Marrëveshjes me sindikatat shqiptare të arsimit.

Ministri Buja informoi pjesëmarrësit mbi arritjet dhe sfidat me të cilat po përballet kjo Ministri dhe vlerësoi mbështetjen e EI dhe AOb, si edhe nënshkrimin e Marrveshjes me sindikatat shqiptare, si një kontribut i drejtpërdrejtë për zhvillimin e sistemit arsimor dhe proceseve demokratike në të dy vendet.

Presidenti i AOb, Walter Dresscher, përfaqësuesi i i EI, Nicolas Richards, Kryetari i FSASH, Xhafer Dobrushi, dhe Kryetari i SPASH, Bajram Kruja, falenderuan Ministrin për Takimin, vlerësuan punën e bërë nga SBASHK dhe shprehën gatishmërinë e subjekteve që përfaqësojnë për vazhdimin e angazhimeve të përbashkëta për zhvillimin e sistemit arsimor ne Kosovë e Shqipëri dhe për mbrojten e interesave social ekonomike të mësuesve të të dy vendeve.

MARRËVESHJE - BASHKËPUNIMI

Në Prishtinë, sot me datën 29 shkurt 2012, përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Arsimit e Shkencës, FSASH, Sindikatës së Pavarur të Arsimit Shqiptar, SPASH dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Republikës së Kosovës, SBASHK, duke shprehur aspiratat e mësuesve dhe gjithë punonjësve të arsimit e sindikalistëve që ata përfaqësojnë, duke patur si objektiv kryesor zhvillimin cilësor bashkëkohor të arsimit shqiptar dhe fuqizimin e lëvizjes sindikale në funksion të këtij objektivi, si edhe për mbrojtjen efektive të kërkesave dhe interesave sociale

Vijon në faqen 4

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis sindikatave shqiptare të arsimit, FSASH e SPASH, dhe sindikatës së arsimit të Kosovës, SBASHK

Vijon nga faqja 3

ekonomike të sindikalistëve e punonjësve të arsimit, nënshkruajnë këtë Marrëveshje – Bashkëpunimi.

SPASH, FSASH dhe SBASHK, mbështetur në statutet e tyre dhe në parimet e organizimit e funksionimit të EI dhe ETUCE, anëtare të të cilave janë, angazhohen që të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për harmonizimin e politikës dhe të objektivave sindikale, të lëvizjeve dhe aksioneve sindikale, me qëllim që të fuqizohet lëvizja sindikale, të rritet objektiviteti dhe forca e saj argumentuese e realizuese.

SBASHK, SPASH dhe FSASH angazhohen që të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre për trajnimin profesional e sindikal të mësuesve dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter historik, kulturor dhe argëtues, që do të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.

a. Në mënyrë të veçantë do të shkëmbehet informacion dhe përvojë për arritjet cilësore në procesin mësimor, në funksionimin e sindikatave dhe në organizimin e punës për minimizimin e braktisjes së shkollës dhe eliminimin të punës së fëmijëve, etj.

b. Palët shprehin gatishmërinë për të mbështetur njëra-tjetrën në rastet e qëndrimeve që ato mbajnë ndaj punëdhënësit, manifestimeve apo grevave, mbrojtjen e të drejtave sindikale, përfshirë edhe mbështetjen e mësuesve e sindikalistëve në trevat shqiptare në Maqedoni, Serbi dhe Malin e Zi.

Palët nënshkruese shprehin gatishmërinë dhe angazhimin e tyre të plotë për të mbështetur dhe ndikuar në plotësimin e Marrëveshjeve ndërshtetërore të nënshkruara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë dhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, për koordinimin e projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit, harmonizimin e planeve e programeve mësimore, uljen e braktisjes në arsimin bazë dhe të mesëm, projektin e Abetares së përbashkët, bashkëpunimin në reformën e kurrikules, etj.

FSASH, SPASH dhe SBASHK, do të ndërtojnë një program të përbashkët, afatmesëm që do të përcaktojë angazhimet konkrete të sindikatave në mbështetje të Marrëveshjeve ndërshtetërore, duke synuar sidomos sensibilizimin e opinionit të masës së mësuesve e sindikalistëve për t'i implementuar në procesin mësimor kërkesat e Marrëveshjes.





Për funksionimin e kësaj Marrëveshjeje – Bashkëpunimi, palët krijuan një Këshill Konsultativ të përbashkët që koordinon dhe udhëheq veprimtaritë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje. Këshilli përbehet nga kryesitë e tri sindikatave dhe bashkëdrejtohet nga kryetarët e tyre. Këshilli i zhvillon takimet, si rregull një herë në vit,ndërsa bashkëkryetarët takohen të paktën dy herë në vit.

Marrëveshja e Bashkëpunimit u hartua në 5 kopje të barazvlefshme dhe u nënshkrua nga kryetarët e të tri sindikatave.

PËR FSASH	PËR SBASHK	PËR SPASH
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Xhafer Dobrushi	Ali Shabanaj	Bajram Kruja

Projekt-Ligji per sistemin arsimor parauniversitar

SHPREHJE E VLERESIMIT PER FIGUREN, MISIONIN DHE PROFESIONIN E MESUESIT

Prej me shume se nje viti, nga hallkat e sistemit te arsimit parauniversitar, nga partneret social, shoqeria civile dhe grupet e interesit eshte duke u diskutuar projekt-ligji per sistemin arsimor parauniversitar qe ka shpallur Ministria e Arsimit dhe Shkences. Eshte i kuptueshem interesimi qe ka ngjallur te Sindikatat e Arsimit diskutimi i ketij projekt-ligji dhe angazhimi aktiv i FSASH dhe SPASH ne kete proces, i cili tani po shkon drejt finalizimit te tij.

Ligji i ri, qe pritet te miratohet, per sistemin arsimor parauniversitar nuk mund te konceptohet dhe ne fakt nuk eshte nje rastesi dhe as nje akt i radhes ose i thjeshte juridik. Ai dallon ne krahasim me ligjin ekzistues te miratuar ne vitin 1995 dhe me ndryshimet qe i jane bere here mbas here atij per faktin se, nga njera ane, pasqyron nje stad te ri te zhvillimit e reformimit te sistemit arsimor parauniversitar ne vendin tone, proces qe ka ndodhur gjate afro 20 viteve, dhe, nga ana tjeter, u jep forme e force ligjore prioriteteve, synimeve dhe objektivave qe vendi yne duhet te realizoje per te vendosur edhe ne fushen e arsimimit te brezit te ri standarde dhe nivele europiane e bashkekohore.

Sic thuhet ne dispozitat e pergjithshme te projekt-ligjit te ri, ligjevenesi synon percaktimin e parimeve baze per strukturen, permbajtjen shkencore, veprimtarine dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar, ne funksion te formimit te brezit te ri, te cdo individi, me dijet dhe vlerat bashkekohore, me aftesite per te perballuar sfidat e se ardhmes, mbi te gjitha, per te formuar qytetare te perkushtuar per mbrojtjen dhe zhvillimin e kultures kombetare e bashkekohore, te vlerave te lirise e demokracise, te progresit shoqeror te atdheut.

Ne projekt-ligjin e ri, ndryshe nga ligji i mepareshem, mesuesi konsiderohet si figura qendrore e shkolles.

Dispozitat qe lidhen me mesuesin, me pavaresine e tij akademike, me mbrojtjen e figures dhe te pozites sociale ekonomike te tyre, kane qene edhe pjeset qe kane ngjallur me shume interes dhe debat ne te gjitha fazat dhe nivelet e diskutimit midis sindikatave dhe Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Po cilat ishin sfidat me te cilat u perballem dhe sa arritem te perfshijme ne projekt-ligj objektivat tona sindikale?

Se pari, mosperfshirja ne ligj e urdherit te profesionit, konkretisht e "Urdherit te Mesuesit". Kjo ka qene arritja kryesore e FSASH/SPASH. Nepermjet negociatave jo vetem me grupin e punes te MASH, por edhe ne disa takime pune me Ministrin dhe, ne vazhdim, edhe me Qeverine, ne arritem te provojme se "urdheri i profesionit" jo vetem ishte i padobishem por edhe i demshem ne arsim. Me argumentet e paraqitura, bazuar ne legjislacionin shqiptar, ne strategjine e arsimit, ne Rekomandimin e ILO-s dhe UNESCO-s " Per Statusin e Mesuesit" dhe ne pervojen e vendeve Europiane, ku me perjashtim te Skocise asnje vend tjeter nuk ka "Urdher Mesuesi", ne arritem t'i bindim partneret tane qe "urdheri i profesionit" eshte i papershtatshem dhe i panevojshem per mesuesit e sistemit parauniversitar. Bazuar ne keto argumente dhe ne dialogun e zhvilluar midis paleve, Qeveria, ne muajin dhjetor 2011, dergoi ne Parlament ndryshimet perkatese ne ligjin per profesionet e rregulluara, gje qe mundesoi perjashtimin e mesuesit nga urdheri i profesionit.

Po cfare humbnin mesuesit, nese do te perfshihej ne Ligj " Urdheri i Mesuesit"?

Pervec te drejtes per t'u legjitimuar se bashku me dikasterin si politikeberes dhe autoritet i vendosjes se standardeve, "Urdheri…" po te perfshihej ne ligj do te bente qe regjistrimi ne Urdher i cdo mesuesi dhe drejtuesi shkolle do te ishte i detyrueshem. Per pasoje, "Urdheri…" do te licensonte mesuesit, do te percaktonte kritere per licensimin dhe pagesen, (qe nuk do te ishte e lehte), qe do te bente cdo mesues ne favor te "Urdherit"

Vijon në faqen 6

SHPREHJE E VLERESIMIT PER FIGUREN, MISIONIN DHE PROFESIONIN E MESUESIT

Vijon nga faqja 5

per te plotesuar keto kritere, pavaresisht faktit se cfare statusi gezonin, cfare vjetersie pune dhe kualifikimi kishin ata ne arsim.

Pervec kesaj, masat administrative, deri te heqja e licenses per ushtrimin e profesionit, do te ishin kompetence e " Urdherit te Mesuesit".

Si anetare te "Urdherit", mesuesit do te paguanin cdo vit ne favore te tij, ne menyre te detyrueshme, nje shume 5-6 here me te madhe se kuotizacioni qe paguajne sindikalistet ne sindikate, etj.

Se dyti, Garantimi i vendit te punes per mesuesit qe aktualisht jane te punesuar me kontrate te perhereshme.

Dy kategori mesuesish, qe aktualisht jane te punesuar me kontrate kolektive pune ne menyre te perhershme, rrezikoheshin dhe rrezikohen. Keta jane:

a. Mesuesit qe kane mbaruar studime universitare trevjecare, 6 semestra, te cilet nese do te barazoheshin me DNP, sic thuhet ne Ligjin e Arsimit te Larte, do te mund te punesoheshin vetem ne arsimin parashkollor. Ky kontigjent perfshine rreth 11.000 mesues, te cilet, vertete kane mbaruar studime universitare 3 vjecare, por keto nuk barazvleresohen me studimet universitare 3 vjecare te nivelit bachelor, sipas sistemit te Bolonjes, sepse ne rastin e pare studimet kane qene me cikel te mbyllur dhe te diplomuarit kane marre titullin "Mesues i Shkolles 8 vjecare", sot 9 vjecare.

Me insistimin e sindikatave, ky rrezik u menjanua dhe, si pasoje, Qeveria, ne dhjetor te vitit 2010, mori vendimin qe i kthen keta mesues, per nje kohe prej 2 vjetesh, ne statusin e meparshem. Sindikatat po insistojne qe ky status i tyre te jete i perhershem.

b. Mesuesit me shkolle te mesme pedagogjike dhe shkolla te tjera profesionale te profilit te mesuesise, qe aktualisht jane te punesuar ne arsim ne ciklin e ulet te arsimit baze dhe ne arsimin parashkollor ne menyre definitive.

Ne draftin e tanishem te Ligjit kjo kategori mesuesish, qe perfshine rreth 5 000 vete, nuk permendet si grup qe do te ruaj vendin e punes, ashtu sic eshte percaktuar ne Kontraten Kolektive te nivelit te pare.

Ne jemi duke negocuar per trajtimin kontraktual ligjor te ketij grupi mesuesish, te cilet sot dhe per disa kohe jane te nevojshem dhe te domosdoshem ne sistemin e arsimit, sidomos ne zonat periferike. Kete ceshtje do ta trajtojme edhe ne Komisionin Parlamentar perkates kur te diskutohet Projekt-Ligji.

Se treti, ne kemi sugjerimet tona edhe per dispozitat qe i referohen emrimit dhe lirimit nga detyra te drejtuesve te shkollave dhe mesuesve. Thelbi i ketyre verejtjeve dhe sugjerimeve eshte qe, per te shmangur politizimet dhe punesimin e te paafteve, ne Ligj te percaktohen disa kritere baze se kush mund te jete drejtor shkolle dhe kush mesues, duke saktesuar me tej draftin ekzistues.

Po keshtu, ligji duhet te sanksionoje qe i njejti organ qe perzgjedh kandidatin per drejtues shkolle apo mesues, po i njejti organ duhet te shprehet edhe per largimin e tyre nga detyra.

Keto verejtje dhe sugjerime jane diskutuar gjeresisht edhe ne mbledhjet e Keshillave Drejtuese te te dy sindikatave. Propozimet konkrete do te parashtrohen ne seancen perkatese te Komisionit Parlamentar.

Por, ketu mendojme te nenvizojme se qellimi i sugjerimeve dhe propozimeve te sindikatave ka qene dhe mbetet sanksionimi ne dispozitat e ligjit te ri te Statusit te Mesuesit, ne ate nivel qe permbajne Rekomandimet e ILO-s dhe te UNESCO, te cilat perbejne standardet bashkekohore per rolin, figuren dhe misionin e mesuesit ne shoqeri, te cilet jane nje kontribut i pazevendesueshem per zhvillimin e individit dhe te shoqerise moderne, formojne inteligjencen tekniko-shkencore si baze per progres te vazhdueshem, jo vetem kulturor e moral, por edhe ekonomik e social te vendit.

Xhafer Dobrushi

FUNKSIONIMI I DIALOGUT SOCIAL NE ARSIM NE NIVELIN E DYTE DHE SIDOMOS NE NIVEL SHKOLLE

(Pervoje dhe probleme)

Nga analiza e bere ne Keshillin Kombetar te Punes

Ne mbledhjen e fundit te Keshillit Kombetar te Punes, si nje ceshtje e vecante, u diskutua dhe analizua edhe **funksionimin e dialogut social ne sektorin e arsimit, sidomos ne nivelin e pare**. Keshilli, ne menyre unanime, vleresoi se sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH, kane zhvilluar me punedhenesin e tyre, Ministrine e Arsimit dhe Shkences, MASH, ne disa raste edhe me Qeverine, nje dialog dhe partneritet social konkret dhe efektiv, i cili nga viti ne vit ka ardhur duke u konsoliduar. Keshilli vleresoi posacerisht pozicionimin bashkekohor te sindikatave te arsimit qe shprehet ne vizionin e tyre, sipas te cilit, **baza per zhvillimin e dialogut e partneritetit social efektiv, te vazhdueshem dhe rezultativ eshte lidhja ngushte e kerkesave sociale - ekonomike te mesuesve dhe gjithe punonjesve te arsimit me objektivat per reformimin dhe zhvillimin progresiv te ketij sektori jetik te shoqerise.** Pervoja e ketyre sindikatave verterton se, nese shkeputet kjo lidhje, nese secili partner nuk merr pergjegjesite e veta, si per mbrojtjen e punonjesve, ashtu dhe per zhvillimin cilesor e reformimin e sektorit perkates, atehere dialogu social do te jete i njeanshem dhe partneriteti do te mbetet formal, jo rezultativ.

Ne materialin e paraqitur ne Keshill nga FSASH/SPASH u theksua se ato kane vazhduar dhe do te vazhdojne t'u permbahen fort si mbrojtjes dhe zbatimit me vendosmeri te kerkesave dhe interesave te sindikalisteve dhe gjithe mesuesve e punonjesve te tjere te arsimit, ashtu edhe angazhimit me pergjegjesi te strukturave sindikale ne procesin e plotesimit te synimeve dhe objektivave per nje arsim cilesor dhe krijimin e shanseve te barabarta per te gjithe, si kusht per zhvillimin dhe progresin e gjithe shoqerise. Angazhimi dhe pergjegjesite konkrete te te dy partnereve, Sindikatave te Arsimit dhe MASH, per t'i konsideruar zhvillimin e arsimit dhe mbrojtjen sociale ne funksion te njeri-tjetrit gjen pasqyrim konkret dhe ligjor ne Kontraten Kolektive te Punes te nivelit te pare te 25 majit 2010, efektet e se ciles shtrihen deri me 31 dhjetor 2014.

Nga analiza qe beri Keshilli Kombetar i Punes doli qarte se shprehje e kesaj lidhjeje dhe angazhimit dypalesh ne zbatim te kuptimit dhe dispozitave te Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare eshte problematika qe eshte shtruar dhe diskutuar midis dy partnereve, sidomos dy vitet e fundit. Konkretisht:

a. Sindikatat e Arsimit kane marre pjese aktive ne gjithe procesin e diskutimit te projekt- ligjit per arsimin parauniversitar. Jane zhvilluar takime ne nivele specialistesh, me grupet e punes te MASH dhe sidomos dispozitatat e projekt – ligjit qe kane te bejne me mesuesin, me Statusin e Mesuesit, jane bere objekt diskutimi disa here me Ministrin e Arsimit dhe Shkences. Qendrimi i sindikatave ka qene dhe mbetet perfshirja ne ligjin e ri te Rekomandimeve te ILO-s dhe UNESCO-s per Statusin e Mesuesit.

b. Te dy sindikatat, bazuar ne nje pervoje te pasur qe kane grumbulluar ne keto 10 vitet e fundit, vazhdojne angazhimin e tyre aktiv per uljen dhe eliminimin e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe per nxjerrjen nga rreziku i braktisjes te nje numri te madh nxenesish qe frekuentojne me nderprerje dhe punojne ne rruge.

c. Ne mbrojtje te mesuesve, Sindikatat e Arsimit, negocuan per disa muaj me MASH, Ministrine e Financave dhe Qeverine dhe arriten te ruajne pozicionimin e rreth 11 000 mesuesve, me diploma universitare 3 vjecare, ne grupin e pare te pagave, me nje perfitim mujor prej 7 000 deri 9 000 leke te reja per secilin nga keta mesues.

d. FSASH/SPASH negocuan me MASH, Ministrine e Financave, DAP-in dhe, mbi kete baze, Qeveria pranoi propozimin per zgjerimin e differences ne page midis mesuesit fillestar dhe mesuesit me vjetersi maksimale, gje qe eshte reflektuar qe ne korrik te ketij viti ne VKM-ne perkates.

e. SPASH/FSASH jane konsultuar gjeresisht me MASH per shpenzimet e transportit te mesuesve, me objektivin qe mesuesit qe punojne larg vendbanimit dhe e meritojne te shperblehen, por edhe fondet e shtetit te mos shperdorohen.

Pa permendur dhe shume probleme te tjera te shtruara dhe te zgjidhura, behet e kuptueshme se kjo problematike e ushqen dialogun social midis MASH dhe Sindikatave te Arsimit ne menyre te vazhdueshme, i ben palet te angazhuara dhe te interesuara qe dialogu te mos nderpritet, por te vazhdoje ne interes te te dy paleve dhe ne funksion te nje qellimi te perbashket qe eshte zhvillimi i nje arsimimi cilesor, te reformuar, te konsoliduar sipas kerkesave te kohes dhe me punemarres, me mesues te mbrojtur sipas standardeve ligjore bashkekohore.

Synimi yne, thuhej ne materialin qe FSASH/SPASH parashtruan ne

Vijon në faqen 8

FUNKSIONIMI I DIALOGUT SOCIAL NE ARSIM NE NIVELIN E DYTE DHE SIDOMOS NE NIVEL SHKOLLE

Vijon nga faqja 7

KKP, **ka qene dhe mbetet jo vetem funksionimi i dialogut social ne nivelin e pare, por edhe shtrirja e tij ne nivelin e dyte, midis DAR/ZA-ve dhe Seksioneve Sindikale te te dy sindikatave te arsimit**.

Ne kete funksion, Sindikatat e Arsimit ne bashkepunim me MASH kane zhvilluar nje Konference Kombetare me pjesemarrjen e drejtoreve te DAR dhe Kryetareve te Seksioneve Sindikale, ku eshte diskutuar per domosdoshmerine e dialogut social ne nivelin e dyte. Po keshtu, ne bashkepunim me MASH jane zhvilluar takime me te gjera ne shkalle vendi dhe zonale, jane bere trajnime te herepashereshme, sidomos te drejtuesve lokale sindikale, me theks kultivimin e kultures se dialogut, njohjen dhe zbatimin e Kontrates Kolektive te nivelit te pare, njohjen e legjislacionit te punes dhe Konventave Nderkombetare te Punes , etj.

Ne Keshillin Kombetar te Punes u rikonfirmua se Sindikatat e Arsimit jane te shtrira me struktura seksioni ne te gjitha rrethet e vendit dhe kane nenshkruar me punedhenesin Kontrata Kolektive te nivelit te dyte. Kjo ka bere qe Seksionet Sindikale ne qarqe e rrethe te kene nje vizion me te plote per domosdoshmerine e dialogut social ne territorin e tyre, qe te vene ne qender te ketij dialogu ato probleme qe preokupojne sindikalistet dhe mesuesit, por edhe vete arsimin ne qark apo rreth.

Drejtuesit e Sindikatave te Arsimit, anetare te Keshillit Kombetar te Punes, theksuan me force se ka akoma Seksione sindikale qe nuk perballojne si duhet nivelin e dialogut me punedhenesin, ashtu sic ka edhe ndonje DAR apo disa ZA, qe nese nuk u imponohet nga strukturat qendrore sindikale apo shtetrore, e kane te veshtire te ulen e te diskutojne me sindikatat per problemet qe cituam me siper. Jane pikerisht keto DAR apo ZA, qe kane edhe rastet me te shumta te moszbatimit apo shkeljeve te Kontrates Kolektive, qe kane bere te domosdoshme nderhyrjen e strukturave qendrore sindikale per te korrigjuar shkeljet. Jane te shumta rastet qe veprime ne kundershtim me Kontraten Kolektive te drejtuesve perkates rajonale apo te ZA-ve, sindikatat i kane denoncuar ne Gjykate. Theksojme se pothuaj te gjitha gjyqet, me ndonje perjashtim teper te rralle, qe jane zhvilluar me inisiativen e sindikatave qendrore apo lokale per mbrojtjen e marredhenieve te punes apo te pagave per mesuesit e demtuar, jane fituar nga sindikatat.

Ne mbledhje u theksua se duke u perpjekur qe dialogun social ta shtrijme dhe gradualisht ta konsolidojme ne te gjithe nivelin e dyte, dmth ne DAR/ZA, te dy palet do te perballen me probleme qe lidhen me aftesine per te perballuar dialogun, per te mesuar dhe rrenjosur kulturen e dialogut, si nga drejtuesit e seksioneve sindikale, ashtu edhe nga drejtuesit e institucioneve arsimore. Por Sindikatat Qendrore jane te vendosura qe te vazhdojne te punojne per ta arritur kete, **si kusht per te kaluar ne ate qe mund ta quajme nivel i trete i dialogut, dialogun mbi baze shkolle.**

Eshte e vertete se aktualisht, de jure, drejtori i shkolles dhe as shkolla si institucion nuk kryen funksione te punedhenesit. Por, kjo nuk i pengon sindikatat ne shkolle, qe per nje game te gjere problemesh qe lidhen me njohjen dhe zbatimin konkret te Kontrates Kolektive, Akteve Normative te Ministrit te Arsimit dhe Shkences, legjislacionit, etj., te dialogojne me angazhimin qe Statusi i Mesuesit, figura e tij, kontributet dhe cilesia e punes se tij, te respektohen e zbatohen ne radhe te pare ne shkolle, qe te terhiqet opinioni i mases se sindikalisteve dhe mesuesve per te luftuar me efikasitet informalitetin, indiferentizmin, paaftesine dhe korrupsionin, per te rritur transparencen, per te arritur qe praktikat e reja qe po futen ne arsimin parauniversitar, si permbajtja e kurrikules, planeve dhe programeve mesimore, alterteksti, puna me nxenesit problematike, etj. te behen ceshtje e te gjithe mesuesve ne shkolle.

Drejtuesit e FSASH/SPASH theksuan ne mbledhje se ne kete faze jane fillimet e para te shtrirjes se dialogut social ne nivelin e shkolles. Por, zhvillimet e reja qe vijne dhe qe lidhen me decentralizimin e kompetencave te drejtimit te arsimit, thane ata, e bejne me te mundur dialogun dhe partneritetin ne nivel shkolle. Edhe sot ka shume shembuj te funksionimit te dialogut social ne nivel shkolle, por qellimi i diskutimit te ketij problemi ne Keshillin Kombetar te Punes eshte per ta njohur organin me te larte te partneritetit social me objektivat dhe pervojen tone, per te kerkuar mbeshtetje institucionale ne objektivat e reja qe synohet te arrihen.

Duke shprehur vleresimin e tyre pozitiv per mundesine qe u dha Keshilli Kombetar i Punes per te diskutuar ne nje sesion te vecante per praktiken dhe pervojen e tyre ne zhvillimin e partneritetit social, drejtuesit e sindikatave vleresuan edhe marredheniet korrekte qe ekzistojne midis tyre dhe Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, me aparatin e ketij dikasteri, me te cilet mbajne kontakte te rregullta dhe te vazhdueshme, perfshire diskutimet per zbatimin drejt e me korrektesi te legjislacionit te punes, te Konventave Nderkombetare te Punes etj.

Veprimtari aktive e rezultative gjate 2011, angazhime efektive gjate 2012 e ne vijim

Nga mbledhja e KD te FSASH

Keshilli Drejtues i FSASH, i mbledhur ne daten 25 shkurt 2012, beri analizen e punes per vitin 2011 dhe percaktoi prioritetet e levizjes sindikale te kesaj Federate dhe te strukturave te saj ne te gjitha nivelet per periudhen ne vijim.

Ne Fjalen Hyrese qe mbajti Kryetari i kesaj Federate, z. Xhafer Dobrushi, ne emer te Kryesise, beri vleresimin per punen, veprimtarine dhe rezultatet e arritura gjate vitit te kaluar dhe paraqiti drejtimet kryesore te punes dhe sfidat me te cilat do te perballen strukturat e kesaj Federate nga qendra ne baze gjate vitit 2012 e ne vazhdim.



Si arritje me te rendesishme u evidentuan:

-Angazhimi i strukturave drejtuese te Federates ne diskutimin e Projektligjit per Arsimin Parauniversitar, duke vene ne dukje sidomos rendesine qe ka hartimi i ketij Ligji me standarde bashkekohore, si baza juridike dhe garancia e procesve reformuese qe jane zhvilluar dhe do te zhvillohen ne arsimin parauniversitar me moton: per nje arsim cilesor dhe per krijimin e shanseve te barabarta per te gjithe nxenesit.

- Rikthimi ne Grupin e pare te pagave te rreth 11.000 mesuesve qe kane kryer studime universitare trevjecare, (6 semestra), te cilet nese do te perfshiheshin ne Grupin e dyte te pasqyres se pagave te punonjesve te arsimit parauniversitar, pra te barazoheshin me DNP, do te pesonin padrejtesisht nje ulje te pages mujore neto nga 7.000- 9000 leke. VKM i dhjetorit 2010, qe kategorine e mesuesve me studime universitare 3 vjecare i perfshiu perseri ne Grupin e pare te pagave, eshte rezultat i kerkeses kembengulese te FSASH/ SPASH.

- Reflektimi i ndryshimeve te nevojshme per zgjidhjen e paqartesive qe jane krijuar nga zbatimi i Vendimit nr.194 date 22.4.1999 (i ndryshuar) per grupin dhe pozicionin ne tabelen e pagave te mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike ose shkolla te tjera profesionale.

- Harmonizimi i pagave te punonjesve te arsimit parauniversitar, per te ngushtuar diferencen midis pages minimale dhe pages maksimale.

- Po keshtu, ne qender te vemendjes se FSASH kane qene negociatat e vazhdueshme dhe arritja e rezultateve konkrete per shpenzimet e transportit te mesuesve dhe shperblimin mbi page te mesuesve qe punojne larg vendbanimit, etj.

Si ne Fjalen Hyrese, edhe ne diskutimet shumta te anetareve te Keshillit Drejtues, u trajtuan problemet e rendesishme te konsolidimit te metejshem te seksioneve sindikale ne rrethe, duke e vene theksin sidomos tek puna qe duhet bere gjate ketij viti e ne vijim **me synimin qe keto seksione te drejtojne e veprojne jo si individe por si organe kolegjiale, qe** te rritet kapaciteti i tyre per te dialoguar, per t'u bere partnere serioze e te pergjegjshem perballe punedhenesit, Drejtorive dhe Zyrave Arsimore, per diskutimin dhe zgjidhjen e kerkesave te sindikalisteve qe ata perfaqesojne, per zbatimin me korrektesi te dispozitave te Kontratave Kolektive te nivelit te pare si dhe te nivelit te

Vijon në faqen 10

Veprimtari aktive e rezultative gjate 2011, angazhime efektive gjate 2012 e ne vijim

Vijon nga faqja 9

dyte, per uljen e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve etj.

Keshilli Drejtues diskutoi dhe miratoi prioritetet dhe objektivat per vitin 2012-2013.



Duke terhequr konkluzionet e duhura nga analiza e punes vjetore, me nje veshtrim me kritik te asaj cka eshte arritur jo vetem gjate vitit 2011, por edhe per shume e shume vite me pare, duke mbajtur parasysh rolin dhe peshen e FSASH ne levizjen sindikale ne arsim si dhe ne levizjen sindikale te te gjithe profesioneve te punemarresve ne shkalle vendi, si nje sindikate e madhe, e organizuar dhe e qendrueeshme; duke u mbeshtetur ne forcen dhe aftesite e FSASH per t'u perballur me sfidat qe e presin, per t'u rritur me shume cilesisht, per ta merituar plotesisht besimin dhe velersimin e derisotem te sindikalisteve, punonjesve dhe partnereve tane; Keshillit Drejtues, e shpalli periudhen e viteve 2012-2013, **si periudhen e konsolidimit te metejshem dhe te rinovimit te te gjithe strukturave sindikale**, duke filluar nga keshillat sindikale ne shkolla apo fakultete dhe deri ne organet me te larta te Federates, **si prioritetin kryesor te levizjes sindikale ne kuader te FSASH.**

Ne mbledhje u theksua se nevoja per reformim, konsolidim dhe rinovim te strukturave sindikale eshte e perhershme. Megjithate, si prioritet mbi cdo synim dhe objektiv tjeter, ajo nuk mund te shpallet ne cdo kohe, sepse kerkon stadin dhe pjekurine e nevojshme, kerkon aftesi dhe garanci per arritjen e ketij objektivi madhor.

Prandaj KD vleresoj se mbas 20 viteve veprimtarie intensive gjithnje ne rritje, FSASH i ka te gjitha mundesite dhe forcat per te programuar dhe synuar objektiva me te avancuara qe lidhen me:

- Plotesimin e strukturave ne te gjithe keshillat dhe seksionet sindikale sipas kritereve statutore, perfshire edhe funksionimin normal i tyre.
- Riaktivizimin e komisioneve te gruas dhe rinise,
- Konsolidimin e Seksioneve Sindikale ne ato njesi vendore qe akoma nuk kane qendrueshmeri.
- Riorganizimin e Seksioneve Sindikale ne rrethet Korce, Lushnje, Peqind,
- Delvine.
- Funksionimin e dialogut social ne te tri nivelet,
- Organizimin e aktiviteteve te shumta e te larmishme ne te gjitha nivelet, me rastin e 100 Vjetorit te Pavaresise.

Me nje angazhim total dhe te pergjegjshem, me pune te vazhdueshme te te gjithe strukturave sindikale, mundesohet ploesisht qe ne vitin 2013, ne nje kohe qe do te gjykohet e pershtatshme ta **konkretizojme kete fushate me nje Kongres te FSASH me moton: RINOVIM DHE KONSOLIDIM I METEJSHEM I STRUKTURAVE SINDIKALE, si kusht dhe garanci per rritjen e forces argumentuese, levizese dhe realizuese te FSASH**, per mundesi cilesisht me te medha dhe qendrueshmeri ne procesin e dialogut social ne te gjithe nivelet, ne te mire te plotesimit dhe zbatimit te kerkesave dhe interesave sociale ekonomike te mesuesve dhe gjithe punonjesve te arsimit, ne te mire te reformimit dhe progresit te sistemit arsimor ne Shqiperi si kusht per progresin shoqeror te vendit.

U MBLODH KESHILLI KOMBETAR I SPASH

Me date 2 dhe 3 mars 2012, ne ambientet e Shkolles Sindikale te BSPSH, u mblodh Keshilli Kombetar i SPASH.Gjate dy diteve u trajtuan problemet aktuale qe kontribuan ne Pavaresine e Shqiperise. Keto aktivitete do te zhvillohen ne kuadrin e zbatimit te Marreveshjes se Perbashket te nenshkruar nga Presidentet e tri



dhe per te ardhmen e SPASH.

Keshilli Kombetar ne kete mbledhje miratoi programin e veprimtarise se SPASH per vitin 2012, ku per kete vit qe eshte edhe viti jubilar i 100-Vjetorit te Pavaresise se Shtetit Shqiptar, perveç veprimtarive qendrore, jane parashikuar edhe aktivitete e veprimtari locale, madje edhe njera nga mbledhjet e planifikuara te Kryesise, e cila do te jete e zgjeruar, eshte vendosur te zhvillohet ne muajin nentor ne Vlore.

Ne fund te muajit gusht dhe ne fillim te shtatorit do te zhvillohen aktivitete te perbashketa me Sindikaten e Arsimit te Kosoves, SBASHK, ku ne qender do te jene figurat e ndritura te Kombit tone sindikatave te arsimit shqiptar, SPASH-FSASH dhe SBASHK, me 29 shkurt 2012 ne Prishtine.

Ne fillim te muajit maj, SPASH do te zhvilloje nje ekskursion turistik ne Selanik e Stamboll, ku ne qender do te jete tema historike e njohjes se vendeve jashte Shqiperise ku zhvilluan veprimtarine disa nga rilindasit dhe patriotet e Kombit Shqiptar per te ardhur deri te Pavaresia.

Ne kete mbledhje Keshilli Kombetar, miratoi, gjithashtu, edhe projekt buxhetin per vitin 2012 ku bie ne sy rritja e te ardhurave e te shpenzimeve per aktivitete me karakter formues ne drejtim te anetareve te rinj, si edhe funksionimi i mire i partneritetit te disa sindikatave, jo vetem me DAR e ZA, por edhe me sektoret financiare te tyre e veçanerisht ne drejtim te zbatimit te Kontrates Kolektive, duke paraqitur lista te qarta e te rifreskuara te anetaresise per ndalesen e kutizacioneve nepermjet borderove.

Keshilli Kombetar vleresoi punen e kryesive te rretheve Tirane, Elbasan, Korçe, Vlore, Lushnje, Delvine etj, dhe u terhoqi vemendjen disa kryesive te rretheve per me shume vleresim e impenjim ne kete drejtim, pasi SPASH u ka krijuar te gjitha mundesite dhe lehtesite ligjore nepermjet kontrates kolektive per partneritet dhe pune me cilesore.

Diten e dyte mbledhja e Keshillit Kombetar u zhvilluan ne formen e nje seminari, ku pasqyrimi i gjendjes aktuale te SPASH u gershetua me mundesite, format dhe metodat e punes qe duhet te zbatojme ne te ardhmen me qellim shtimin e anetaresise, konsolodimin e sindikates dhe rritjen e cilesise se punes se drejtuesve te saj, veçanerisht ne zbatimin e kontrates kolektive te nivelit te pare, te dyte e ne nivel shkolle. Keto probleme u trajtuan nga z. Defrim Spahiu e Nevrus Kaptelli, ku nga pasqyrimi i gjendjes reale te anetaresise per çdo strukture, krahasuar kjo edhe me derdhjen e kuotizacioneve per vitin 2011, e cila u pasqyrua nga z.Selahedin Llukaçej, u kalua ne mundesite dhe metodat e punes qe duhet te ndiqen per nje sindikate me te konsoliduar, duke filluar qe nga shkolla. Sa me funksional te jete dialogu social dhe partneriteti ne

Vijon në faqen 12

U MBLODH KESHILLI KOMBETAR I SPASH

Vijon nga faqja 11

shkolle, aq me pak mundesi do te kete futja e elementeve pa identitet per te perçare e shkaterruar levizjen sindikale, siç ndodhi ne disa rrethe e veçanerisht ne Durres. Per te shmangur kete Presidenti i SPASH, z.Bajram Kruja, terhoqi vemendjen qe informacionet, kualifikimet dhe zgjidhja e problemeve nga sindikata t'u shperndahen te gjitha strukturave sindikale e te njihet me to anetaresia ne çdo shkolle.

Ai, gjithashtu, evidentoi punen e mire qe ka bere ne kete drejtim kryetari i SPA Lezhe, z. Pjeter Prenga, dhe kembenguli qe kjo duhet te jete metode pune e te gjithe drejtuesve te SPA te rretheve, me qellim qe anetaresia te njihet me punen e sindikates per mbrojtjen e interesave te tyre.

Gjate seminarit pjesemarresit i pershendeti edhe Presidenti i BSPSH-se z.Gezim Kalaja.

Ai vleresoi punen e mire ne drejtim te funksionimit dhe te kontributit te SPASH per vitin 2011 ne kuader te BSPSH dhe kerkoi qe keto rezultate te ruhen e permiresohen gjate vitit 2012.

Ne fund Presidenti i SPASH, z.Bajram Kruja, falenderoi Z.Kalaja per mbeshtetjen e dhene SPASH-it dhe anetaret e Keshillit Kombetar per bashkepunimin.

DISA NGA ARRITJET E SPASH GJATE KETIJ MANDATI

Mbrojtja social - ekonomike dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes te mesuesve, si edhe mbrojtja e te drejtave sindikale te drejtuesve te sindikatave, kane qene nga drejtimet kryesore te SPASH-it, qe nga krijimi i saj, si edhe gjate ketij mandati ne vijim.

Ne kete drejtim kohet e fundit jane shenuar disa arritje, midis te cilave permendim:

1. Nryshimi i Udhezimit te MASH Nr.3, date 03. 02. 2010, i cili parashikonte:

- Norma e mesuesit te gjuhes dhe letersise nga 20 ore behej 22 ore.

- Percaktohej perfitimi i uljes se normes mesimore vetem kryetaret e sindikates me te perfaqesuar.

Pas kundershtimit te sindikates, ne lidhje me kete Udhezim, u arrit dalja e Udhezimit te ri me Nr.5 date, 13. 02. 2010 ku percaktohej se:

- Norma e mesuesit te gjuhes dhe letersise mbetet 20 ore.

- E drejta per uljen e ne normes mesimore u kthye per te dy kryetaret e seksioneve sindikale ne rrethe sipas Nenit 13.4 te Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare.

2. Angazhimi per permiresimin e Projekt Ligjit per Arsimin Parauniversitar.

Si partnere sociale dhe grupe interesi, na u kerkua dhenia e mendimeve si SPASH. Ne ngritem grup pune dhe, pas disa takimesh, i paraqitem me shkrim me shkresen Nr. 66, date 26. 01. 2011 dhe i mbrojtem propozimet tona ne disa takime me grupin e punes te MASH te drejtuar nga Zv. Ministri, Z.Halit Shamata. Ne shume prej tyre rame dakord, por per Urdherin e Mesuesit nuk rame dakord. Pasi u konsultuam edhe me specialistet e EI dhe me disa sindikata homologe siguruam mbeshtetjen e tyre dhe ata zyrtarisht iu drejtuan MASH dhe, me mbeshtetjen edhe te Kryeministrit, Urdheri i Mesuesit u hoq nga Projekt Ligji.

3. Duke qene partnere me MASH dhe Qeverine, gjate negocimeve per rritjen e pagave te punonjesve te sistemit te arsimit parauniversitar per vitin 2011, kerkuam qe, per mesuesit me vjetersi ne pune mbi 25 vjet, rritja te ishte 10% dhe per mesuesit me me pak se 25 vjete pune rritja te ishte 6%, kjo per arsye se per 12 vjet ne kerkuam rritjen e pagave per mesuesit e rinj, dhe kur keto u rregulluan, tani profesioni i mesuesit eshte profesion i kerkuar, por u ngushtua diferenca midis pages minimale (te mesuesit te ri) me pagen maksimale (te mesuesit me mbi 25 vjet pune) duke arritur ne 19%, kur Evropa e ka rreth 30%. Ndaj kerkesa jone u vleresua e drejte dhe me VKM Nr.554 dt.11. 08. 2011, vlera e pages se grupit te pare, nga 12000 leke u be 13000 leke. Ne te ardhmen ne do te kerkojme perseri rritjen pak me te madhe te pages per mesuesit me mbi 25 vjet pune, me qellim arritjen e standardeve te Europes.

4. Sipas VKM Nr.617 date 08. 07. 2010, mesuesit me diploma te nivelit te pare (DNP), u perfshine ne grupin e dyte te pagave, nga 12000 ne 10000 leke dhe keta ishin te gjithe mesuesit me institute tre vjeçare me cikel te mbyllur. Kjo nuk na u duk e

arsyeshme per shkak te arsimit te tyre te plote dhe te punes se kryer. Sipas cikleve ku ata punonin, paga u zbriste me shume se 4000 dhe 8000 leke. Per kete ne, me argumente, iu drejtuam MASH, Ministrise se Financave dhe Kryeministrit dhe me VKM Nr.1036 date 10. 12. 2010, keta mesues u rikthyen ne grupin e pare.

5. Transporti i mesuesve ka paraqitur shqetesim. Per arsye te gjendjes financiare, MASH kerkoi transporti te jete falas,10 deri 20 km, veç transportit falas, mesuesesve t'u paguhet edhe veshtiresia e largesise me 1000 leke dhe mbi 20 km 1800 leke. Per kete, pas propozimit tone derguar MASH dhe Ministrise se Financave, me date 02.09.2011, doli VKM Nr.709, date 05. 10. 2011, sipas propozimit tone.

6. Ne VKM Nr.1036, date 10.12. 2010, per strukturat e pagave, ne pikat 11,,12,,13, dhe 14 nuk jane ndare pagat e grupit Financave dhe shpresojme te gjejme mirekuptim per percaktim me 12 kategori pagash, ku i pergjigjet arsimi dhe pozicioni ku punon.

7. Keshilli Kombetar i Punes, ne mbledhjen e tij te dates 02.11. 2011 mori ne analize nivelin e partneritetit te sindikatave te arsimit me MASH dhe Qeverine dhe vleresoi zhvillimin e dialogut social ne te tre nivelet, sindikate – Ministri, sindikate-DAR,ZA dhe sindikate- drejtori shkolle.



heqjen e pageses se veshtiresise se largesise per mesuesit qe punonin larg vendbanimit dhe nga qeveria u kerkua mendimi i sindikatave te arsimit. Ne nuk pranuam heqjen e pageses, por ne mbeshtetje te Kontrates Kolektive, propozuam qe per largesine 5 deri ne 10 km, qartesisht per grupin 2 dhe 3 dhe, per pasoje, jane bere pagesa te njellojta per arsim jo te barabarte.

Ky shqetesim i yni nuk gjeti zgjidhje ne MASH dhe per kete iu drejtuam Ministrise se Financave dhe Kryeministrit.

Erdhi pergjigjja nga Ministria e

SPASH do te vazhdoje te jete plotesisht e angazhuar per te mbrojtur mesuesit e sidomos ata anetare te saj dhe per te vazhduar te jape kontributin e saj per zhvillimin cilesor te arsimit ne vendin tone.

Nevrus Kaptelli

TAKIM ME DREJTORET E DAR/ZA-ve

Ditet e fundit, ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences u zhvillua nje takim i kryetareve te FSASH/SPASH me drejtoret e Drejtorive Rajonale Arsimore dhe Zyrave Arsimore te vendit.



Tema qendrore e takimit ishte " Kuptimi dhe zbatimi drejte i dispozitave te Kontrates Kolektive te nivelit te pare, kusht per zhvillimin rezultativ te dialogut social ne nivelin e dyte".

Drejtuesit e Sindikatave Qendrore, z. Xhafer Dobrushi dhe z. Bajram Kruja, parashtruan ne kete takim pervojen pozitive qe eshte arritur nga shume DAR/ZA ne kuptimin dhe zbatimin e Kontrates



Kolektive te Punes dhe terhoqen vemendjen ne problematiken qe qendron para punedhenesit ne nivelin e dyte dhe Seksioneve Sindikale ne rrethe per zbatimin me korrektesi te detyrimeve dy-paleshe qe rrjedhin nga Kontrata dhe qe jane te detyrueshme per t'u zbatuar.

Ne takim u diskutua, gjithashtu, per domosdoshmerine e paisjes se cdo shkolle me Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive te nivelit te pare, me qellim qe, mbi bazen e tyre, te krijohen mundesi per zhvillimin e dialogut social edhe ne nivelin e trete, ne nivel shkollave, midis drejtoreve te shkollave dhe keshillave sindikale perfaqesuese te Sindikatave Qendrore nenshkruese te Kontrates Kolektive te Punes qe ka hyre ne fuqi me 25 maj 2010 dhe i shtrine efektet deri me 31 dhjetor 2014.

Palet rane dakord qe ne muajt e ardhshem takime



te tilla te organziohen ne cdo Drejtori dhe Zyre Arsimore me drejtuesit e shkollave dhe perfaqesuesit e sindikatave, per te zberthyer e diskutuar rreth korpusit te legjislacionit te punes, ne baze te te cilit rregullohen ligjerisht marredheniet midis partnereve social, midis punedhenesit dhe punemarresit.

Nje takim i tille, u organizua keto dite ne Zyren Arsimore te Kavajes, ku moren pjese drejtoret e shkollave te ketij rrethi, punonjes te Zyres Arsimore, etj. Ne kete takim, Drejtori i Zyres Arsimore, z. Artan Lilamani, dhe Kryetaret e Sindikatave Qendrore folen per rendesine dhe mundesite e zhvillimit te dialogut social ne nivel shkolle me synimin qe dialogu te funksionoje mbi bazen e Kodit te Punes, legjislacionit shqiptar dhe Kontrates Kolektive te Punes dhe t'i sherbeje ngritjes cilesore te punes se shkolles dhe mbrojtjes se kerkesave dhe interesave te mesuesve e sindikalisteve.

Botim i rendesishem per eliminimin e punes se femijeve

Ne vijim te punes se tyre per angazhimin e mesuesve, nxenesve dhe aktoreve te tjere per eliminimin e punes se femijeve, dy sindikatat tona te arsimit, FSASH e SPASH, botuan ne janar te ketij viti Broshuren "ELIMINIMI I PUNES SE FEMIJEVE, ÇESHTJE E RENDESISHME SINDIKALE", e cila eshte vazhdim i disa broshurave qe keto sindikata kane botuar ne kuadrin e projekteve qe ato kane zbatuar ne bashkepunim me sindikatat holandeze AOb e FNV, me Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe me ILO-IPEC.

Ky botim, i cili u realizua me mbeshtetjen financiare te sindikates se arsimit te holandes, AOb, vjen ne nje etape te rendesishme te realizimit te objektivave dhe te angazhimit prej me shume se dhjete vjecar te FSASH e SPASH per minimizimin e fenomenit te braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve.

Botimi eshte konceptuar ne formen e nje Manuali, ku perfshihen disa konkluzione te nxjerra nga pervoja e deritanishme e dy sindikatave te arsimit ne angazhimin e tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, disa udhezime praktike per nje veprimtari rezultative ne kete drejtim, si edhe Konventat kryesore, Ligje e Vendime qe percaktojne standardet nder-kombetare dhe ato kombetare per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se femijeve. Botimi synon te jete nje Manual lehtesisht i perdorshem nga drejtuesit e sindikalistet dhe nga te gjithe mesuesit qe jane te angazhuar ose qe pritet te angazhohen ne aktivitetet per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Manuali eshte prezantuar ne mbledhjet respektive te Keshillit Drejtues te FSASH dhe te Keshillit Kombetar te SPASH dhe eshte shperndare per perdorim ne te gjithe seksionet e tyre sindikale ne rrethe



Duke qene nje Manual qe perfshin pervoje, udhezime praktike dhe standarde nderkombetare e kombetare, ai do te sherbeje edhe si baze per trajnime, seminare e workshope me drejtues lokale e aktiviste te FSASH e SPASH, me synim pergatitjen e tyre per nje pune te sukseseshme per mbajtjen e nxenesve ne shkolle dhe eliminimin e punes se femijeve.

FSASH dhe SPASH i shprehin mirenjohjen Sindikates se Arsimit te Holandes, AOb, per ndihmen dhe kontributin e madh qe ka dhene dhe vazhdon te jape per mbeshtetjen e sindikatave tona ne kete angazhim m e rendesi te vecante per zhvillimin e arsimit dhe per te ardhmen e shoqerise sone.

Stavri Liko



TRIBUNA SINDIKALE